



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 23.15.1-2013-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË RREGULLATORIT**  
**PËR ENERGJI**  
**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013**

**Prishtinë, Qershor 2014**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Energji në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi, i mbështetur nga Edona Abazi (Udhëheqëse e Ekipit) dhe Alban Beka (Anëtar i Ekipit).

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia .....	6
2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli .....	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	22
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	25

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në memon e planifikimit të auditimit, të datës 15 nëntor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyra vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Zyrës Rregullatore për Energji (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013, pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes*, Regjistri i Pasurive fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

## **Konkluzioni i përgjithshëm**

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit për Energji kishte dizajnuar një sistem relativisht të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Progresi i bërë lidhur me adresimin e rekomandimeve, tregon gatishmërinë e tyre për të përmirësuar në vazhdimësi sistemin e kontrollit të brendshëm.

Mirëpo, edhe përpos kësaj ne kemi vërejtur disa fusha të cilat kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Realizimi i buxhetit ishte në një nivel më të ulët në raport me vitin paraprak për 9%.

Shpenzimet e Pagave dhe Mëditjeve nuk ishin menaxhuar në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Buxheti ishte aprovuar për 33 punonjës, mirëpo pothuajse i gjithë buxheti, ose 94% në këtë kategori ishte shpenzuar për 27 sa ishin gjatë vitit 2013. Këtë situatë e kishin shkaktuar pagesat për shtesa të ndryshme për të cilat nuk kishte kritere të matshme sa duhet. Më tutje, rregullorja e brendshme për menaxhimin e automjeteve, ose disa nene të saj ishin në kundërshtim me parimet e përgjithshme për menaxhimin e pasurisë qeveritare. Ato rregullonin përdorimin e automjeteve edhe për qëllime private.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, kontrolle shtesë nevojiten edhe në menaxhimin e procedurave të prokurimit si dhe në menaxhimin e shpenzimeve tjera të cilat nuk kërkojnë prokurim.

## **Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:**

Kryesuesi i Bordit të Zyrës Rregullatore të Energjisë duhet të siguroj se:

- Përgatitja e buxhetit parapraket nga analiza që pasqyron të gjitha informatat relevante, përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Performanca buxhetore duhet të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuar për nivelet e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë;
- Të gjitha pagat dhe shtesat për punonjësit, rregullohen duke u bazuar në kritere të qarta dhe sa më objektive; dhe
- Ka shqyrtuar mundësinë për rishikimin e rregullores për menaxhimin e automjeteve, duke eliminuar mundësinë për përdorimin e tyre për qëllime private. Kontrolle shtesë nevojiten edhe në menaxhimin e kërkesave paraprake për udhëtim.

## **Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2013**

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet tona.

---

# 1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

## 2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

ZRRE, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

### 2.1 Opinioni i Auditimit

#### Opinion i pamodifikuar<sup>1</sup>

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes*, Regjistri i Pasurive fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale'), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).**

<sup>1</sup> Termi „opinion i pamodifikuar“ është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar“ i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

### Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh nëse:

- PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Janë përmbushur të gjitha kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- PVF-të janë pranuar në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- ZRRE, ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore në Ministri të Financave gjatë vitit 2013.

Informatat e prezantuara në PVF janë të sakta dhe në pajtim me planin kontabël, përveç informacioneve mbi pasuritë, të cilat nuk janë raportuar në mënyrë të saktë.

---

### Çështja 1 - Mos evidentim i automjetit në regjistrin kontabël të pasurive - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas rregullores për Menaxhimin e Pasurive Jo-financiare, të gjitha pasuritë pas pranimit të tij dhe kalimit nën mbikëqyrje nga OB, duhen të evidentohen në regjistrin kontabël të pasurive, pavarësisht pagesës apo jo të faturës përkatëse.

ZRRE gjatë muajit dhjetor 2013 kishte blerë një automjet me vlerë prej 23,900€, ku fatura nga Operatorit Ekonomik (OE) ishte pranuar me datë 27.12.2013. Nga kjo kemi vërejtur se pasuria në fjalë nuk ishte evidentuar në regjistrin kontabël të pasurive- SIMFK.

**Rreziku** Mos evidentimi i pasurive të reja në regjistrin kontabël ka ndikuar në nënvlerësimin e vlerës së pasurisë kapitale.

**Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë me vlerë mbi 1,000€ regjistrohen në SIMFK, dhe të njëjtat prezantohen në PVF.

## 2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

### Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ZRRE kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë Pasqyrat Nëntëmujore Financiare;
- Raportimet mbi ecurinë e projekteve kapitale;
- Draft plani i prokurimit;
- Raportet mbi obligimet e papaguara; dhe
- Plani për implementimin e rekomandimeve.

Lidhur me pajtueshmërinë e kërkesave për raportim të jashtëm, ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto.

## 3 Rekomandimet e vitit paraprak

### Konkluzioni i përgjithshëm

ZRRE nuk kishte arritur të përgatisë me kohë planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve. Megjithatë, ata kishin adresuar pjesën më të madhe të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të vitit paraprak.

### Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2012 të ZRRE-së ka rezultuar me katër rekomandime kryesore.

Deri në fund të auditimit tonë konstatuam se nga rekomandimet e dhëna, tri janë adresuar plotësisht, dhe një ishte në proces të adresimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është e fokusuar në kuptimin dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti, për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe të kontrollit. Ne vlerësojmë nëse kontrollet janë dizajnuar mirë, janë implementuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë, nevojitet vlerësimi i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të paraqitura nga menaxhmenti. Ne konsiderojmë çështje të veçanta siç janë: aplikimi i vetë-vlerësimit të MFK-së dhe vlerësimi i rrezikut.

Menaxhmenti i ZRRE-së kishte dizajnuar një sistem relativisht të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar.

Mirëpo, edhe përpos kësaj në kemi vërejtur disa fusha të cilat kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Realizimi i buxhetit nuk ishte në një nivel të kënaqshëm, përkatësisht kishte rënie të shpenzimit për 9% në raport me vitin paraprak.

Shpenzimet e Pagave dhe Mëditjeve nuk ishin menaxhuar në pajtueshmëri me kornizën ligjore. Buxheti ishte aprovuar për 33 punonjës, mirëpo pothuajse i gjithë buxheti, ose 94% në këtë kategori ishte shpenzuar për 27 sa ishin gjatë vitit 2013. Këtë situatë e kishin shkaktuar pagesat për shtesa të ndryshme për të cilat nuk kishte kritere të matshme sa duhet. Më tutje, rregullorja e brendshme për menaxhimin e automjeteve, ose disa nene të saj ishin në kundërshtim me parimet e përgjithshme për menaxhimin e pasurisë qeveritare. Ato rregullonin përdorimin e automjeteve edhe për qëllime private.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, kontrolle shtesë nevojiten edhe në menaxhimin e procedurave të prokurimit si dhe në menaxhimin e shpenzimeve tjera të cilat nuk kërkojnë prokurim.

## 4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

### Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ZRRE-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>684,456</b>	<b>684,456</b>	<b>587,520</b>	<b>643,502</b>	<b>604,624</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	684,456	684,456	587,520	643,502	604,624

Nga tabela më lartë vërejmë se buxheti final nga ai fillestar nuk ka pësuar ndryshime.

ZRRE gjatë vitit 2013 ka shpenzuar 587,520€ apo 86% të buxhetit final. Krahasuar me realizimin e buxhetit të vitit 2012 (prej 95%), ky nivel i shpenzimit për vitin 2013 është dukshëm më i ulët.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>684,456</b>	<b>684,456</b>	<b>587,520</b>	<b>643,501</b>	<b>604,624</b>
Pagat dhe Mëditjet	372,456	372,456	351,830	372,319	368,082
Mallrat dhe Shërbimet	250,000	240,000	194,068	219,893	187,776
Shpenzimet Komunale	12,000	22,000	18,626	10,159	8,747
Investimet Kapitale	50,000	50,000	22,996	41,130	40,019

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Siç vërehet edhe në tabelën më sipër, buxheti fillestar nga ai final si total, nuk ka ndryshime. Mirëpo nëse analizojmë sipas kategorive ekonomike, vërejmë një transfer të fondeve në mes kategorisë Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzime Komunale, në vlerë prej 10,000€. Ky transfer është bërë me kërkesë nga ZRRE për Ministrinë e Financave (MF), pas ndërrimit të

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

lokacionit, ku për këtë arsye ka pasur rritje të shpenzimeve të energjisë elektrike (kalimi nga nxehtë me naftë në atë me energji elektrike).

Nëse i krahasojmë shpenzimet me buxhetin final sipas kategorive ekonomike, vërejmë një realizim të ulët tek kategoritë: Mallra dhe Shërbime me 81%; Shpenzime Komunale me 84% dhe Investime Kapitale me 46%. Ky realizim i dobët në kategoritë Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzime Komunale, vjen si pasoje e planifikimit jo të mirë. Përderisa te kategoria e Investimeve Kapitale, janë planifikuar tri projekte të cilat janë realizuar brenda vitit, mirëpo për njërin projekt pranimi i faturës nga OE, ishte bërë në fund të vitit, dhe pagesa kishte arritur të realizohej në shkurt të vitit 2014. Prandaj, figuron si kategori me realizim të ulët.

Ndërkaq realizim më të lartë, vërejmë në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve me 94%.

---

## Çështja 2 - Dobësi në ekzekutimin e buxhetit - Prioritet i lartë

- E gjetura** ZRRE nuk kishte arritur të bënte një realizim më të mirë të buxhetit të planifikuar. Diferencat në kategoritë e Mallrave dhe Shërbimeve, Shpenzimeve Komunale dhe Investimeve Kapitale, tregon qartë se planifikimi nuk është bazuar në analiza dhe llogaritje përkatëse.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe ekzekutimi i ulët i tij mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se përgatitja e buxhetit paraprihet nga analiza që pasqyron të gjitha informatat relevante, përfshirë realizimet e vitit paraprak dhe ndryshimet e pritura gjatë vitit. Performanca buxhetore duhet të monitorohet në baza mujore dhe barrierat e identifikuarra për nivelet e ekzekutimit buxhetor të adresohen me kohë.

## 4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

### Përshkrimi

ZRRE, për vitin 2013 kishte arritur të realizonte të hyra në vlerë 683,073€. Këto të hyra kanë të bëjnë me taksat e paguara nga kompanitë shpërndarëse të energjisë elektrike.

Ne kemi testuar disa nga këto lloje të hyrash, ku kemi ardhur në konkludim se ZRRE kishte arritur të vendos kontrollë funksionale në menaxhimin, regjistrimin dhe raportimin e tyre.

### Rekomandimet

Ne nuk kemi asnjë rekomandim në këtë fushë.

---

## 4.4 Shpenzimet

### 4.4.1 Prokurimi

#### **Përshkrimi**

ZRRE, gjatë vitit 2013 kishte nënshkruar 19 kontrata përmes procedurave të prokurimit në vlerë 93,299€. Prej tyre ne testuam nëntë lëndë, në vlerë prej 79,330€, ose shprehur në përqindje 85% e vlerës së kontratave.

Po ashtu, ne kemi testuar 24 pagesa në vlerë 41,828€, të cilat kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit.

---

#### **Çështja 3 - Realizimi i shpenzimeve pa kontratë - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Sipas të dhënave të Thesarit, shpenzimet vjetore për vitin 2013 për bileta të udhëtimeve zyrtare ishin 18,434€, ndërsa shpenzimet e telefonisë mobile kapin vlerën prej 10,045€. Gjatë testimeve vërejtëm se këto shpenzimeve janë realizuar pa kontratë.

**Rreziku** Furnizimi me bileta dhe me mbushje të telefonave mobil pa kontratë rritë rrezikun që të paguhen çmime më të larta në raport më çmimet reale të tregut.

**Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që shërbimet telefonike dhe të biletave janë zhvilluar me procedura të prokurimit, pasi kjo siguron shërbime cilësore dhe kosto më të ulët.

#### **Çështja 4 - Mangësi gjatë procesit të certifikimit të pagesave - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Puna jonë ka përfshirë edhe ekzaminimin e disa pagesave për të verifikuar rregullsinë në procesin e certifikimit të tyre. Këto teste kanë identifikuar disa gabime teknike të cilat kanë rrjedhë si pasojë e mungesës së kontrolleve në këto procese:

- Sipas rregullave të Thesarit, fillimisht duhet të procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimin të faturës të ekzekutohet pagesa në fjalë. Mirëpo, gjatë testimit të pagesave kemi vërejtur se gjatë procesimit të tyre, nuk janë zbatuar këto rregulla. Urdhërblerja është bërë pas pranimin të faturës; dhe
- ZRRE ka nënshkruar kontratë për 'Furnizim me pajisje të TI-së' në vlerë prej 9,888€. Pagesa e këtyre pajisjeve ishte bërë nga Investimet Kapitale, edhe pse çmimi i tyre për njësi ishte nën 1,000€. Derisa, sipas rregullave të Thesarit të gjitha blerjet për njësi nën 1,000€ duhet të realizohen dhe regjistrohen në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.

**Rreziku** Çertifikimi i pagesave në mungesë të dëshmive të mjaftueshme, rritë rrezikun të realizohen pagesa të parregullta të cilat mund të rezultojnë në shfrytëzim jo efektiv të fondeve publike.

**Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë, se funksioni i certifikimit të pagesave do të verifikoj të gjithë dokumentacionin, dhe vetëm pas plotësimit të plotë të të gjitha kushteve ligjore të certifikohen pagesat.

## 4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam 16 pagesa për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimeve zyrtare.

Bazuar në këtë vërejtëm çështjet si në vijim:

---

### Çështja 5 - Parregullsi në procedurat e udhëtimeve zyrtare- Prioritet i mesëm

- E gjetura** Tek avansi për udhëtime zyrtare në Bruksel me vlerë 5,000€, kemi vërejtur se ZRRE, pavarësisht mëditjeve të dhëna kishte paguar edhe darka zyrtare në vlerë 367€. Shpenzimet për darka zyrtare nuk parashihen në U.A nr.2004/07 'Për udhëtime zyrtare jashtë vendit'. Kjo shumë është aprovuar nga Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së dhe është regjistruar në kodin ekonomik 14310 - dreka zyrtare.
- Rreziku** Pagesat për shpenzimet të cilat nuk parashihen me U.A përkatës mund të rezultojnë në shfrytëzim jo efektiv të fondeve publike.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të forcoj kontrollet financiare lidhur me menaxhimin e avanseve, dhe të sigurohet se shpenzimet për udhëtime zyrtare jashtë vendit bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## Çështja 6 – Vonesë në mbyllje të avanseve- Prioritet i mesëm

**E gjetura** Udhëzimi Administrativ nr.2004/07 për udhëtimet zyrtare, kërkon që mbyllja e avansit të bëhet 15 ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar. Në dy raste të testuara vërejtëm se avanset ishin mbyllur me vonesë:

- Avansi për udhëtim zyrtar i hapur me datë 15.04.2013 në vlerë prej 2,000€, është mbyllur me datë 16.12.2014, ose tetë (8) muaj me vonesë; dhe
- Avansi për udhëtim zyrtar i hapur me datë 22.07.2013 në vlerë 2,000€, është mbyllur me datë 08.10.2013, ose me rreth tre (3) muaj vonesë.

**Rreziku** Vonesat në mbylljen e avanseve rrisin rrezikun që paraja publike të përdoret në mënyrë të parregullt nga persona të caktuar.

**Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që kontrollet financiare lidhur me menaxhimin e avanseve janë përforcuar. Të gjithë personat që shfrytëzojnë avance, të bëjnë barazimet e duhura brenda periudhës së kërkuar ligjore.

### 4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

#### Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollet që operojnë në nivel të ZRRE-së, kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Buxheti final për Paga dhe Mëditje ishte 372,456€, ndërsa numri i buxhetuar i punonjësve ishte 33. Derisa, shpenzimet e realizuara për këtë kategori ishin 351,830€, dhe deri në muajin dhjetor 2013 ishin 27 punonjës.

Në kuadër të kësaj kategorie, ne kemi testuar 23 mostra, duke përfshirë procedurat e rekrutimit, dosjeve të personelit, rregullsinë e shpërndarjes së shtesave dhe respektimin e afateve ligjore.

### **Çështja 7 – Dhënia e pagave variable pa ndonjë kriter sqarues- Prioritet i lartë**

- E gjetura** ZRRE me një vendim të marrë nga Bordi, ka caktuar skemën e pagave në përputhje me strukturën organizative. Sipas kësaj, përveç pagës bazë, punonjësit do të përfitojnë edhe një shumë të caktuar si pjesë variable. Nga testimet, kemi vërejtur se kjo pjesë nuk është rregulluar me një kriter të qartë dhe objektiv për arsyen dhe mënyrën e dhënies së tyre.
- Rreziku** Caktimi i shtesave për punonjësit pa ndonjë kriter dhe politikë të qartë, rritë rrezikun që fondet e alokuara për këtë kategori të mos shfrytëzohen në mënyrë efikase, dhe që lartësia e këtyre shtesave të mos shpërndahet në mënyrë objektive për tërë stafin.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që të gjitha pagat dhe shtesat për punonjësit, rregullohen duke u bazuar në kritere të qarta dhe sa më objektive.

### **Çështja 8 – Mosplotësim i vendeve të punës- Prioritet i mesëm**

- E gjetura** ZRRE për vitin 2013 me aprovim të buxhetit kishte 33 punonjës, aktualisht janë 27. Edhe përkundër kësaj buxheti për Paga dhe Mëditje shfrytëzohet pothuajse plotësisht (me 94%). Ajo që kemi vërejtur është se ky numër i punonjësve prej 33, me kërkesë nga ZRRE dhe i aprovuar me buxhet, figuron qysh nga vitet e kaluara.
- Rreziku** Mosplotësimi me staf i pozitive të lira shkakton vështirësi në realizimin e plotë të detyrave të ZRRE-së.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa konkrete për plotësimin e vendeve të lira.

## Çështja 9 - Tejkalim i afatit ligjor si U.D nga udhëheqësit e lartë - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Me vendimin e Bordit për ristrukturimin e organizatës për vitin 2013, njëkohësisht është marrë vendim për shuarjen e disa pozitave, dhe hapjen e disa pozitave të reja. Nga kjo kemi vërejtur se:

- Në njërën nga pozitat e reja ishte ajo e Udhëheqësit të Departamentit për Çmime dhe Tarifa. Bordi, me datë 23 janar 2013 për këtë pozitë ka caktuar një zyrtar si Ushtrues Detyre (UD). Pavarësisht shpalljes së konkursit në muajin mars, rekrutimi nuk kishte përfunduar deri në muajin shtator; dhe
- Rasti i njëjtë ishte edhe te pozita e Udhëheqësit të Departamentit për Energji Termike dhe Gaz. Edhe kjo pozitë ishte mbuluar nga një zyrtar i thirrur si U.D i këtij departamenti. Për këtë pozitë, konkursi është shpallur në muajin prill, ndërsa nuk është realizuar deri në muajin shtator. Këto vonesa në zhvillimin e procedurave kanë ndodhur si shkak i neglizhencës nga komisioni vlerësues.

**Rreziku** Mbajtja e pozitave kyçe si ushtrues detyre për një kohë të gjatë, rrezikon në humbjen e ndjenjës së përgjegjësisë së këtyre zyrtarëve, për të arritur objektivat e përcaktuara.

**Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se bëhet një planifikim i qartë i procedurave të rekrutimit, dhe njëkohësisht këto procedura realizohen në përputhje me planin.

## 4.5 Pasuritë dhe Detyrimet

### 4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

#### **Përshkrimi**

Pasuritë me vlerë mbi 1,000€ të ZRRE, sipas regjistrit kontabël (SIMFK), ishin në vlerë 120,208€, ndërsa pasuritë me vlerë nën 1,000€ ishin 41,692€.

Gjatë auditimit ne kemi testuar nëse janë implementuar rekomandimet lidhur me inventarizimin e pasurive dhe vendosjen e barkodeve, evidentimin e pasurive të përfituara gjatë vitit 2013 në regjistrat përkatës dhe harmonizimin e këtyre regjistrave me informacionet e prezantuara në PVF.

---

#### **Çështja 10 - Dobësi në menaxhimin e automjeteve - Prioritet i lartë**

**E gjetura** ZRRE nuk kishte kontrole të mira në menaxhimin dhe përdorimin e automjeteve. Shfrytëzimi i tyre ishte bërë në mungesë të kërkesave të aprovuara nga menaxhmenti përkatës.

Gjatë vitit 2013, ZRRE kishte nxjerrë një rregullore të brendshme për menaxhimin e automjeteve zyrtare. Kjo rregullore, përkatësisht disa nga nenet e saj nuk janë në pajtim me kërkesat për menaxhimin e pasurisë publike. Neni 5- mundëson përdorimin lokal të automjeteve pa ndonjë kërkesë; Neni 6- mundëson përdorimin e automjeteve jashtë detyrave zyrtare, përkatësisht për qëllime private; dhe Neni 7- përcakton rregullat për transportimin e personave që nuk janë zyrtarë të autoritetit.

**Rreziku** Mungesa e respektimit të procedurave për menaxhimin dhe përdorimin e automjeteve, rrezikon në shfrytëzim jo racional të tyre. Kjo mund të pasojë me kosto shtesë të karburanteve, si dhe shpenzimeve tjera rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

**Rekomandimi 10** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se rregulla për menaxhimin e automjeteve është rishqyrtuar, duke eliminuar mundësinë për përdorimin e tyre për qëllime private. Kontrolle shtesë nevojitet edhe në menaxhimin e kërkesave paraprake për udhëtim.

### Çështja 11 - Mungesë e regjistrit E-Pasuria - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Sipas Rregullores për Menaxhimin e Pasurive, çdo Organizatë Buxhetore duhet mbajë regjistrin E-pasuria, për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€. Pastaj ky regjistër duhet të jetë i harmonizuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurive.

ZRRE nuk kishte funksionalizuar akoma regjistrin E-pasuria. Pasuritë e kësaj kategorie, ishin prezantuar vetëm në bazë të regjistrit të përgjithshëm. Gjithashtu në regjistrin e pasurive SIMFK mungon numri serik i pasurive të përgjithshme.

**Rreziku** Në mungesë të regjistrit E-pasuria, informata e prezantuara nuk do të jenë në përputhje me formatet standarde të kërkuara, andaj të dhënat e prezantuara mund të jenë konfuze.

**Rekomandimi 11** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se të gjitha kërkesat ligjore përmbushen në plotësi, duke përfshirë këtu edhe kërkesat për funksionalizimin e E-pasurisë. Gjithashtu, regjistri duhet të jetë i plotë dhe të përmbajë të gjitha të dhënat e kërkuara në tabelën përkatëse.

## 4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

### Përshkrimi

Shuma totale e të arkëtueshmeve për vitin 2013, ishte në vlerë 2,509€. ZRRE kishte adresuar këshillën e dhënë në muajin dhjetor 2013 (nga shuma prej 84,472€ sa ishte më 30 shtator 2013, 81,963€ ishin mbledhur në katër muajt e fundit).

Inkurajojmë ZRRE-në që të vazhdojë edhe më tutje me përmirësimin e politikave për grumbullimin e të arkëtueshmeve, duke përfshirë këtu edhe borxhet e mbetura nga vitet e kaluara.

### 4.5.3 Trajtimi i borxheve

#### **Përshkrimi**

Krahasuar me vitet paraprake, ZRRE për vitin 2013 kishte raportuar një vlerë më të lartë të obligimeve. Vlera e prezantuar në PVF ishte 27,294€, ku prej tyre: 3,120€ në Mallra dhe Shërbime; 275€ në Shpenzime Komunale dhe 23,900€ në Investime Kapitale.

Ne kemi testuar mënyrën e raportimit të tyre dhe kemi bërë teste substanciale. Nga kjo kemi ardhur në konkludim se ZRRE kishte raportuar obligimet në Thesar sipas afatit ligjor, dhe njëkohësisht kishte prezantuar drejtë në PVF-të e vitit 2013.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

#### **Përshkrimi**

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, ZRRE nuk i plotëson kushtet për themelimin e saj.

Megjithatë, në raportet e auditimit në vitet e mëhershme kemi rekomanduar ZRRE-në të diskutoj me komisionet relevante në Kuvendin e Kosovës që të sigurojë një zgjidhje afatgjatë për shërbimet e auditimit të Brendshëm.

Megjithatë, për vitin 2013 Kuvendi i Kosovës nuk kishte ofruar ndonjë zgjidhje sa i përket auditimit të ZRRE-së, dhe si rrjedhojë e kësaj ky vit kishte kaluar pa iu nënshtruar auditimit të brendshëm.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit Të Çështjes.

## Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4.3. Kërkesat e raportimit	Të përgatisë raportin për vetëvlerësim dhe kontrole të brendshme, për të vlerësuar efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar.	Po		
4.5.2. Pagat dhe Mëditjet	Menaxhmenti duhet të hartoj një dokument i cili do të rregullonte mbajtjen e dosjeve dhe azhurnimin e tyre.	Po		
4.6.1. Pasuritë	Të bëhet inventarizimi i pasurisë sipas kërkesës me U.A. nr 21/2009, me qëllim që të vërtetohet gjendja e të gjithë pasurisë.	Po		
4.6.1. Pasuritë	Të vendosen barkodet tek të gjitha pasuritë.		ZRRE ishte në përfundim të furnizimit të të gjitha pasurive me barkode.	